Kronikë

# Qarkulloni me automatik me silenciator në makinë, arrestohet 2 persona! U gjendet dylbi e montuar dhe krehër me 21 fishekë

*Arian Popa dhe Herolind Sadikaj janë arrestuar nga policia e Shkodrës, pasi janë kapur duke qarkulluar me armë zjarri në makinë. Arian Popa ishte në kërkim për kultivim kanabisi e armëmbajtje.*

Arma e sekuestruar

Redaksia
11 Tetor, 14:26 | **Përditesimi: 11 Tetor, 14:50**

Arian Popa, 38-vjeç dhe Herolind Sadikaj, 21-vjeç, janë arrestuar nga policia e Shkodrës, pasi janë kapur duke qarkulluar me armë zjarri në makinë. Arian Popa ishte në kërkim për kultivim kanabisi e armëmbajtje.

Sipas policisë në rrugën dytësore të fshatit Bajzë, Malësi e Madhe, është ndaluar për kontroll drejtuesi i makinës tip "Volkswagen" me drejtues Arian Popën dhe pasagjer Herolind Sadikajn.


LEXO EDHE:
**Shkodër/ Mashtronin përmes bursës, në pranga administratori dhe menaxherja në një Call Center, 7 operatorë nën hetim! Arrestohen dhe 3 specialistët e teknologjisë**

Pas kontrollit policia ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një armë zjarri automatik, me silenciator, dylbi të montuar dhe me krehër me 21 fishekë.

Në përfundim të veprimeve, u ndalua shtetasi Arian Popa, 38 vjeç, banues në Shirokë, Shkodër, i shpallur në kërkim pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor  Shkodër, me vendimin e datës 19.06.2022, i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike" dhe "Mbajtja pa leje e armëve dhe e municionit luftarak", në kuadër të veprimeve procedurale për operacionin "Vallas".

Gjithashtu u arrestua në flagrancë pasagjeri në automjetin që drejtonte 38-vjeçari, shtetasi Herolind Sadikaj, 21 vjeç, banues në Gjakovë, Kosovë, për veprat penale "Mbajtja pa leje e armëve dhe e municionit luftarak" dhe "Përkrahja e autorit të krimit".

Vijon puna për kapjen e personave të tjerë që janë shpallur në kërkim në kaudër të operacionit "Vallas".

M.Q./Shqiptarja.com

**TAG:** arian popa | herolind sadikaj | malesi e madhe | Shkoder

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Negociatat Berisha-Alibeaj, a mendoni se PD do garojë me një kandidat të përbashkët në zgjedhjet vendore?**
Po Jo Nuk e di

## Lajme të tjera


Politikë
**Denoncon 'Rithemelimi': Korrupsion në shkollën profesionale në Shkodër, paratë shkojnë në xhepat e zyrtarëve të bashkisë së Vaut të Dejës**
28 Shtator, 12:25


Sociale
**Konflikti për parcelën e kanabisit, vritet 44-vjeçari në Pukë! Shpallet në kërkim Maltin Gjini, e qëlloi me plumb në bark**
28 Shtator, 08:41


Sociale
**Të shtëna me armë zjarri në Pukë, vdes 44-vjeçari! U dërgua në spital nga dy persona të paidentifikuar, ndërroi jetë në sallën e operimit (EMRI)**
27 Shtator, 21:20


Kronikë
**Mungesa e socialistëve, dështon mbledhja e këshillit bashkiak në Shkodër, ministrja Bilali 'dush të ftohtë' këshilltarëve të PS: Kulm i jo njerëzores**
27 Shtator, 13:04

Kultura
**Moti i keq në Qarkun e Shkodrës, Emergjencat Civile: Dëme në ura, rrugë e kanale vaditëse**
27 Shtator, 09:35

Kronikë
**Reshjet e shiut në Pukë, prurjet e përrenjve dëmtojnë urat që lidhin fshatrat! Kryebashkiaku: Situata është e vështirë**
27 Shtator, 08:40

**Moti i keq në Shkodër, prurjet e lumenjve dëmtojnë urën që lidh 2 fshatrat**
26 Shtator, 18:02


**15 vjet nga ndarja nga jeta e françeskanit At Zef Pllumit**
25 Shtator, 21:15


**Aksident në aksin Shkodër-Hani i Hotit, plagosen rëndë dy persona! Një nga drejtuesit është oficer policie**
24 Shtator, 21:30

Kronikë

**Në kërkim, por mori hakun e babait! Djali i Ismet Çekorjes të ekzekutuar në 2 shtator vrau 19-vjeçarin në Shkodër për hakmarrje**
22 Shtator, 18:32

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje